



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 132

Tiranë – E enjte, 24 korrik 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 16.7.2025	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisionit disiplinor në Inspektoratin e Përgjithshëm.....	19247
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 16.7.2025	Për përcaktimin e institucioneve që riorganizohen sipas ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.....	19250
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 409, datë 16.7.2025	Për përcaktimin e afateve të testimit fillestar, intervaleve të testimit periodik, si dhe të procedurës së provimit e të kriterëve të vlerësimit	19251
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 427, datë 23.7.2025	Për autorizimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare për zhvillimin e pronave shtetërore për realizimin e projektit të investimit “Rijetëzimi i kompleksit sportiv ‘Skënderbeu’, Korçë, stadiumit dhe zonës urbane përreth”.....	19255
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 428, datë 23.7.2025	Për transferimin të Korporatës së Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore për realizimin e projektit të investimit “Rijetëzimi i kompleksit sportiv ‘Flamurtari’, Vlorë, stadiumit, pallatit të sportit dhe zonës urbane përreth”.....	19257
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 429, datë 23.7.2025	Për lirim nga detyra.....	19259



VENDIM
Nr. 406, datë 16.7.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË
HOLLËSISHME PËR FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT DISIPLINOR NË
INSPEKTORATIN E PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë rregullat e hollësishme për funksionimin e komisionit disiplinor në Inspektoratin e Përgjithshëm dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prej tij për organizimin e procedurës disiplinore dhe vendimmarrjen.

2. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Komision disiplinor”, organi *ad hoc*, i ngritur në Inspektoratin e Përgjithshëm, që shqyrton dhe trajton rastet e shkeljeve disiplinore, të kryera nga kryeinspektorët qendrorë dhe inspektorët e të gjitha pozicioneve në inspektoratet qendrore, strukturat e tjera inspektuese në fushën e zbatimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe në Inspektoratin e Përgjithshëm;

b) “Kryeinspektor qendror”, nëpunësi me funksione inspektimi, që drejton veprimtarinë e inspektoratit qendror dhe ushtron kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin e posaçëm;

c) “Inspektor”, nëpunësi, që ushtron funksione inspektimi në inspektoratet qendrore në strukturat e tjera inspektuese ose në Inspektoratin e Përgjithshëm, në pozicionet inspektor, përgjegjës sektori, drejtor drejtorie ose kryeinspektor i drejtorisë rajonale;

ç) “Struktura të tjera inspektuese”, strukturat, që kryejnë funksione inspektimi dhe që janë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, por nuk janë të organizuara si inspektorate qendrore;

d) “Procedurë disiplinore” përfshin gjithë veprimtarinë administrative që kryhet, që nga momenti i konstatimit të shkeljes së pretenduar disiplinore, vënies në dijeni, me shkrim, të kryeinspektorit apo inspektorit, që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga komisioni disiplinor. Pranimi i kërkesës për procedimin disiplinor shënon fillimin e procedurës disiplinore;

dh) “Provë”, e dhëna, dëshmia, dokumenti apo fakti, që shërben në nxjerrjen e konkluzioneve të procedimit disiplinor dhe që merret në përputhje me dispozitat e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative;

e) “Vendim përfundimtar”, vendimi i komisionit disiplinor për marrjen e masës disiplinore ose ndërprerjen e ecursë disiplinore.

3. Parimet kryesore, mbi bazën e të cilave zhvillon veprimtarinë komisioni disiplinor, janë:

a) parimi i transparencës;

b) parimi i ligjshmërisë dhe i barazisë para ligjit;

c) parimi i procesit të rregullt disiplinor, që garanton të drejtën për t’u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur;

ç) parimi i proporcionalitetit në përcaktimin e masës disiplinore;

d) parimi i pavarësisë dhe paanësisë;

dh) parimi i mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialitetit;

e) parimi i përgjegjësisë;

ë) parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

**II. PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI I
KOMISIONIT DISIPLINOR**

1. Komisioni disiplinor shqyrton rastet e shkeljeve të lehta, të rënda dhe shumë të rënda, të kryera nga kryeinspektor i qendror dhe nga inspektor i në inspektoratet qendrore, në strukturat e tjera inspektuese dhe në Inspektoratin e Përgjithshëm.

2. Komisioni disiplinor ngrihet me urdhër të inspektorit të Përgjithshëm.

3. Komisioni disiplinor, për inspektorin e të gjitha pozicioneve në inspektoratet qendrore, përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ka këtë përbërje:

a) zëvendësinspektorin e Përgjithshëm ose një drejtor drejtorie pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, i cili kryeson komisionin;

b) një përgjegjës sektori pranë Inspektoratit të Përgjithshëm;



c) kryeinspektorin qendror ose një përfaqësues të caktuar prej tij në drejtorinë qendrore të inspektoratit qendror, ku inspektori ka emërimin.

4. Në rastin e procedimit disiplinor të inspektorit në strukturat e tjera inspektuese, komisioni disiplinor ka në përbërje anëtarët e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, të këtij kreu, dhe drejtuesin në strukturat e tjera inspektuese. Në rastin e procedimit disiplinor të drejtuesit të strukturës tjetër inspektuese, komisioni disiplinor ka në përbërje anëtarët e përcaktuar në shkronjat “a” e “b”, të pikës 3, të këtij kreu, dhe titullarin e institucionit, ku drejtuesi ka emërimin.

5. Në rastin e procedimit disiplinor të kryeinspektorit qendror, komisioni disiplinor përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ka në përbërje 2 (dy) anëtarët e përcaktuar në shkronjat “a” e “b”, të pikës 3, të këtij kreu, dhe 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministri përgjegjës, në nivel sekretar i përgjithshëm ose drejtor i përgjithshëm në ministrinë përgjegjëse.

6. Në rastin e procedimit disiplinor të inspektorit të Inspektoratit të Përgjithshëm, komisioni disiplinor ka në përbërje 2 (dy) anëtarë të pozicioneve drejtor drejtorie dhe 1 (një) anëtar, përfaqësues nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore pranë Inspektoratit të Përgjithshëm.

7. Anëtarët e komisionit disiplinor duhet të tërhiqen nga procedimi disiplinor, në rastet kur ekzistojnë një nga pengesat ligjore të parashikuara në nenin 30, të Kodit të Procedurave Administrative. Me njoftimin e heqjes dorë ose me konstatimin nga komisioni disiplinor, që anëtari është në kushtet e pengesës ligjore, inspektori i Përgjithshëm vendos zëvendësimin e anëtarit ose kërkon caktimin e përfaqësuesit nga inspektorati qendror, nga struktura tjetër inspektuese ose nga ministria përgjegjëse, që do të zëvendësojë anëtarin e tërhequr nga komisioni disiplinor. Inspektorati qendror, struktura tjetër inspektuese ose ministria përgjegjëse cakton përfaqësuesin brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike dhe njofton menjëherë inspektorin e Përgjithshëm.

8. Për rastet kur konstatohet pamundësia e vijimit të pjesëmarrjes në komision të njërit prej anëtarëve të komisionit, sipas përcaktimit në pikën 7, të këtij kreu, apo në raste të pamundësisë objektive, inspektori i Përgjithshëm cakton një përfaqësues tjetër, brenda një afati prej 3 (tri) ditësh pune, nga momenti i konstatimit të këtij fakti.

9. Në kuptim të pikës 8, të këtij kreu, raste të pamundësisë objektive konsiderohen rastet e mëposhtme:

a) martesa e anëtarit, paraardhësit apo pasardhësit të tij;

b) lindja e fëmijës për baballarët;

c) vdekja e prindërve, e gjyshërve, e bashkëshortit, e fëmijës, e vëllezërve, e motrave;

ç) sëmundja e rëndë e anëtarit, e fëmijës, e prindërve apo e bashkëshortit, të vërtetuara me raport mjekësor.

10. Mbledhja e komisionit disiplinor është e vlefshme kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij dhe drejtohet nga kryetari.

11. Kryetari i komisionit disiplinor kryen këto detyra:

a) administron dosjen hetimore, objekt shqyrtimi të komisionit disiplinor për zhvillimin e procedimit disiplinor;

b) cakton dhe njofton për datën e vendin e mbledhjes dhe merr konfirmimin me shkresë ose mjete elektronike të anëtarëve të komisionit disiplinor dhe kryeinspektorit apo inspektorit, ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor;

c) cakton dhe njofton rendin e ditës së çdo mbledhjeje, si dhe cakton relatorin e çështjes;

ç) hap, drejton dhe mbyll mbledhjen e komisionit disiplinor, duke siguruar mbarëvajtjen e saj, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;

d) administron materialet e nevojshme për procedimin disiplinor, të cilat kërkojnë nga anëtarët e tjerë;

dh) së bashku me anëtarët e tjerë, merr vendim për pranimin e kërkesës për heqjen dorë ose përjashtimin e anëtarit të komisionit disiplinor, kur ka konflikt interesi apo ka dyshime në lidhje me paanësinë e tij në vendimarrje;

e) siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta;

ë) u jep fjalën anëtarëve të tjerë të komisionit ose palëve në procedimin disiplinor, nëse ata e kërkojnë, për të paraqitur pretendimet dhe sqarimet e tyre;

f) nënshkruan të gjitha aktet e nxjerra nga komisioni disiplinor.

12. Anëtari i komisionit disiplinor kryen të paktën këto detyra:

a) njofton, me shkrim ose në rrugë elektronike, kryetarin për pjesëmarrjen në mbledhjen e komisionit disiplinor;



b) merr pjesë në mbledhje dhe respekton dispozitat e këtij vendimi;

c) ruan të dhënat me të cilat është njohur gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, duke respektuar parimin e konfidentalitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) paraqet kërkesën për heqje dorë nga shqyrtimi i procedimit disiplinor, në rast konflikti interesi ose të një pengese ligjore;

d) voton për vendimet që merr komisioni disiplinor;

dh) nënshkruan të gjitha aktet e nxjerra nga komisioni disiplinor;

e) çdo detyrë tjetër, sipas këtij vendimi, ose që i caktohet nga kryetari.

13. Komisioni disiplinor mbështetet nga sekretariati teknik, veprimtaria e të cilit mbikëqyret nga drejtuesi i burimeve njerëzore pranë Inspektoratit të Përgjithshëm. Në urdhrin për ngritjen e komisionit disiplinor caktohet një punonjës nga njësia e burimeve njerëzore pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, në cilësinë e sekretariatit teknik, i cili ndihmon kryetarin dhe anëtarët e komisionit disiplinor gjatë procedimit disiplinor.

14. Sekretariati teknik ushtron këto detyra:

a) përgatit njoftimet për mbledhjen e komisionit disiplinor;

b) krijon kushtet për mbarëvajtjen e procedurës;

c) kryen të gjitha procedurat për të siguruar administrimin e dokumentacionit të nevojshëm për procesin e vendimmarrjes së komisionit disiplinor;

ç) mban procesverbalin e mbledhjeve;

d) përgatit dosjen që lidhet me rendin e ditës së mbledhjes dhe të gjitha faktet e provat e administruara me çështjen në shqyrtim.

15. Komisioni disiplinor mblidhet dhe zhvillon seancën dëgjimore, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga nxjerrja e urdhrit të inspektorit të Përgjithshëm për ngritjen e komisionit dhe zhvillimin e procedimit disiplinor.

16. Kryetari i komisionit disiplinor cakton datën e mbledhjes, jo më vonë se 3 (tri) ditë kalendarike nga marrja e urdhrit të inspektorit të Përgjithshëm.

17. Kur nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm për mbledhjen, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër të afërt.

18. Në seancën dëgjimore, kryeinspektori apo inspektori paraqitet vetë ose cakton një përfaqësues, sipas ligjit. Në rast se pas dy njoftimeve të

njëpasnjëshme, kryeinspektori, inspektori apo përfaqësuesi ligjor nuk paraqiten, procedura disiplinore vazhdon në mungesë.

19. Dokumentimi i të gjithë veprimtarisë së komisionit disiplinor gjatë mbledhjes pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes, i cili përmban:

a) datën dhe vendin e mbledhjes;

b) anëtarët që marrin pjesë në mbledhje;

c) çështjet që u diskutuan në mbledhje;

ç) vendimet që u morën në mbledhje;

d) dorëheqjet e anëtarëve dhe arsyet përkatëse;

dh) rezultatet e votimit dhe arsyetimin e votimit të secilit anëtar.

20. Procesverbali i mbledhjes u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga kryetari, anëtarët dhe sekretari teknik.

21. Marrja e vendimeve në mbledhjen e komisionit disiplinor bëhet me votim, i cili është individual dhe i hapur. Secili prej anëtarëve ka të drejtën e ushtrimit të një vote. Në asnjë rast, anëtarët e komisionit disiplinor nuk mund të abstenojnë.

22. Vendimet e komisionit disiplinor miratohen me shumicën e gjithë anëtarëve të komisionit dhe arsyetohen në mënyrë të plotë. Arsyetimi i anëtarit që ka votuar “kundër” depozitohet në sekretariatin teknik dhe përcillet bashkë me vendimin përfundimtar.

23. Vendimi përfundimtar i komisionit disiplinor për marrjen e masës disiplinore përmban këto të dhëna:

a) organin që ka marrë vendimin;

b) identifikimin e inspektorit ose kryeinspektorit ndaj të cilit është zhvilluar procedimi disiplinor dhe është marrë masa disiplinore;

c) datën e miratimit;

ç) masën e marrë;

d) shkeljen faktike;

dh) bazën ligjore;

e) arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve, që janë bërë shkak për marrjen e vendimit;

ë) rastet e mëparshme të shkeljeve të ngjashme dhe të masave disiplinore të marra;

f) një listë dhe kopje të të gjitha dokumenteve, që mbështesin masën disiplinore të dhënë;

g) nënshkrimin e të gjithë anëtarëve të komisionit disiplinor.

24. Vendimi zbardhet brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga shpallja e vendimit në 3 (tri) kopje origjinale: një kopje mbahet nga Inspektorati i



Përgjithshëm, një kopje nga ministria përgjegjëse/inspektorati qendror/struktura tjetër inspektuese dhe një kopje i përcillet kryeinspektorit apo inspektorit të proceduar.

25. Inspektori i Përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e paraqitjes së vendimit të komisionit disiplinor dhe materialeve shoqëruese, nxjerr urdhrin për zbatimin e masave që vendosen në procedimin disiplinor, në të cilin parashikohen edhe modalitetet e zbatimit të tij.

26. Vendimi i komisionit disiplinor përkatës bëhet pjesë e dosjes personale të kryeinspektorit ose inspektorit pranë burimeve njerëzore të institucionit përkatës.

III. DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

1. Deri në përfundimin e procesit të riorganizimit të institucioneve me funksione inspektimi, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dispozitat e këtij vendimi do të zbatohen edhe për kryeinspektorin dhe inspektorin e inspektoratit shtetëror e të strukturave të tjera përgjegjëse për inspektimin.

2. Për institucionet/strukturat me funksione inspektimi, për të cilat nuk janë parashikuar ndryshime në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nuk zbatohen parashikimet e këtij vendimi.

3. Ngarkohen ministritë përgjegjëse, Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore dhe strukturat e tjera inspektuese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 408, datë 16.7.2025

PËR PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE QË RIORGANIZOHEN SIPAS LIGJIT PËR INSPEKTIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 3, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me

propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet me funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore, në fushën e zbatimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të cilat i nënshtrohen procesit të riorganizimit, janë, si më poshtë vijon:

a) Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;

b) Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

c) Agjencia Kombëtare e Pyjeve;

ç) Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;

d) Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve;

dh) Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;

e) Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;

ë) Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës;

f) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;

g) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore;

gj) Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;

h) Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;

i) Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;

j) Instituti i Shëndetit Publik.

2. Funksionet inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit transferohen në inspektoratet e reja qendrore, që do të krijohen sipas fushave të inspektimit, që mbulojnë ministritë përgjegjëse dhe sipas parimeve të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM
Nr. 409, datë 16.7.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE TË
TESTIMIT FILLESTAR, INTERVALEVE
TË TESTIMIT PERIODIK, SI DHE TË
PROCEDURËS SË PROVIMIT E TË
KRITEREVE TË VLERËSIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton afatet për zhvillimin e testimit fillestar dhe intervalet e testimit periodik, rregullat për realizimin e procedurës së testimit fillestar dhe periodik të inspektorit, si dhe kriteret e vlerësimit të provimit.

2. Ky vendim synon të sigurojë standardizimin, transparencën dhe objektivitetin e procesit të testimit, duke garantuar që inspektorët të kenë njohuritë, aftësitë dhe integritetin e nevojshëm për ushtrimin e funksionit të tyre, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të veprimtarisë inspektuese.

3. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Testimi fillestar”, procesi i vlerësimit të njohurive dhe aftësive të inspektorit, që ndodhet në kohë prove, i cili zhvillohet në përfundim të trajnimit të detyrueshëm, me qëllim verifikimin e përgatitjes së tij profesionale për ushtrimin e funksionit inspektues;

b) “Testimi periodik”, procesi i vlerësimit të njohurive, që i nënshtrohet inspektorit, në intervale të përcaktuara kohore, me qëllim verifikimin e përditësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale, në përputhje me zhvillimet ligjore, institucionale dhe praktikat më të mira të inspektimit;

c) “Inspektor”, nëpunësi që ushtron funksione inspektimi në inspektoratet qendrore, në strukturat e tjera inspektuese ose në Inspektoratin e

Përgjithshëm, në pozicionet “inspektor”, “përgjegjës sektori”, “drejtor drejtorie” ose “kryeinspektor i drejtorisë rajonale”;

ç) “Inspektor në kohë prove”, nëpunësi që është emëruar për herë të parë në një drejtori qendrore ose rajonale të inspektoratit qendror, strukturat e tjera inspektuese ose në Inspektoratin e Përgjithshëm, i cili i nënshtrohet kohës së provës, që zgjat 3 (tre) muaj nga data e lidhjes së kontratës së punës;

d) “Strukturat e tjera inspektuese”, struktura që kryejnë funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore dhe që janë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, por nuk janë të organizuara si inspektorate qendrore.

4. Testimi profesional fillestar e periodik organizohet nga Inspektorati i Përgjithshëm.

5. Testimi fillestar dhe periodik i inspektorit dhe inspektorit në kohë prove realizohet nga komisioni i rekrutimit dhe ecurisë në karrierë (në vijim “KREK”).

6. Testimi profesional fillestar bëhet në bazë të një testimi me shkrim dhe me gojë për inspektorin në kohë prove, ndërsa testimi periodik bëhet vetëm në bazë të testimit me shkrim.

7. Procedurës së testimit fillestar i nënshtrohet vetëm inspektori në kohë prove në Inspektoratin e Përgjithshëm dhe në inspektoratin qendror, në përfundim të trajnimit të detyrueshëm.

8. Procedurës së testimit periodik i nënshtrohet:

a) inspektori i konfirmuar, përgjegjësi i sektorit, drejtori i drejtorisë në inspektoratet qendrore, strukturat e tjera inspektuese dhe në Inspektoratin e Përgjithshëm;

b) kryeinspektori i drejtorisë rajonale në inspektoratin qendror.

9. Moskalimi i testimit fillestar në përfundim të kohës së provës shkakton moskonfirmimin në fund të kohës së provës për pozicionin “inspektor”.

10. Moskalimi i testimit periodik, për shkaqe që varen nga vetë inspektori, sjell largimin nga detyra të inspektorit.

KREU II
TESTIMI FILLESTAR

1. Inspektori në kohë prove i nënshtrohet procedurës së testimit fillestar në jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, pas përfundimit të



trajnimin të detyrueshëm, sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Inspektorati i Përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e lidhjes së kontratës të inspektorit në kohë prove për zhvillimin e trajnimit të detyrueshëm, njofton inspektorin dhe strukturën përgjegjëse të inspektoratit qendror, nëpërmjet njoftimit elektronik.

3. Trajnimi i detyrueshëm duhet të kryhet brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve punë nga data e lidhjes së kontratës të inspektorit në kohë prove.

4. Inspektorati i Përgjithshëm përcakton datën e testimit fillestar dhe njofton inspektorin nëpërmjet njoftimit elektronik dhe njësinë e burimeve njerëzore përkatëse, të paktën 10 (dhjetë) ditë pune përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e testimit.

5. KREK-u përzgjedh nga banka e pyetjeve pyetjet për testimin me shkrim dhe me gojë, bazuar në fushën e njohurive për të cilat do të zhvillohet testimi, sipas rregullave të përcaktuara për metodologjinë e testimit.

6. Sistemi i vlerësimit bazohet në testimin me shkrim dhe me gojë, me 100 pikë, nga të cilat 70 pikë për testimin me shkrim dhe 30 pikë për testimin me gojë.

7. KREK-u, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga realizimi i testimit, nxjerr rezultatet e testimit me shkrim e me gojë.

8. Inspektorati i Përgjithshëm njofton inspektorin nëpërmjet njoftimit elektronik dhe inspektoratin qendror për rezultatin e testimit, sipas këtij pikëzimi:

- a) 90–100 pikë, “shkëlqyeshëm”;
- b) 76–89 pikë, “shumë mirë”;
- c) 61–75 pikë, “mirë”;
- ç) 51–60 pikë, “kënaqshëm”;
- d) 0–50 pikë, “jokënaqshëm”.

9. Inspektori që është vlerësuar “shkëlqyeshëm”, “shumë mirë” dhe “mirë” konsiderohet i përshtatshëm për pozicionin e punës, ku është emëruar dhe konfirmohet në pozicionin “inspektor”.

10. Inspektori që është vlerësuar “kënaqshëm” konsiderohet i përshtatshëm për pozicionin e punës, ku është emëruar dhe konfirmohet në pozicionin “inspektor”, me kushtin që të ndjekë programe trajnimi të vazhdueshme, të cilat synojnë plotësimin e dobësive, që ka shfaqur gjatë kësaj procedure.

11. Inspektori që është vlerësuar “jokënaqshëm” konsiderohet jo i përshtatshëm për pozicionin e

punës, ku është emëruar dhe nuk konfirmohet në pozicionin “inspektor”.

12. Mosparaqitja e inspektorit në testimin fillestar, pa shkaqe të arsyeshme, sjell moskonfirmimin në pozicionin “inspektor” në fund të kohës së provës.

13. Në kuptim të pikës 12 të këtij kreu, shkaqe të arsyeshme konsiderohen rastet e mëposhtme:

a) martesa e inspektorit, paraardhësit apo pasardhësit të tij;

b) lindja e fëmijës për baballarët;

c) vdekja e prindërve, e gjyshërve, e bashkëshortit, e bashkëjetuesit, e fëmijës, e vëllezërve, e motrave apo e anëtarëve të tjerë të familjes;

ç) sëmundja e rëndë e vetë inspektorit, e fëmijës, e prindërve, e bashkëshortit apo e anëtarëve të tjerë të familjes, vërtetuar me raport mjekësor apo në rast përkujdesjeje për fëmijën në ngarkim.

14. Në rast të mosparaqitjes në testimin fillestar, për një nga shkaqet e arsyeshme në pikën 13 të këtij kreu, inspektori do t'i nënshtrohet procedurës së testimit fillestar, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e rikthimit në punë. Në këtë rast nuk zbatohet afati për njoftimin e testimit, sipas përcaktimeve në pikën 4 të këtij kreu.

KREU III TESTIMI PERIODIK

1. Intervali i testimit periodik për inspektorin është çdo 4 (katër) vjet, sipas procedurave dhe kritereve përkatëse të vlerësimit, të parashikuara në këtë vendim.

2. Inspektorati i Përgjithshëm njofton inspektorin dhe strukturën përgjegjëse të inspektoratit qendror, nëpërmjet njoftimit elektronik, 30 (tridhjetë) ditë pune përpara datës së parashikuar për zhvillimin e testimit periodik.

3. Testimi periodik për inspektorin zhvillohet vetëm me shkrim.

4. KREK-u përzgjedh pyetjet e testimit me shkrim nga banka e pyetjeve për testimin periodik, e cila hartohet nga Inspektorati i Përgjithshëm, sipas fushave përkatëse të inspektimit.

5. KREK-u, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga realizimi i testimit periodik, nxjerr rezultatet, sipas pikëzimit të përcaktuar në pikën 8, të kreut II, të këtij vendimi.



6. Në fund të testimit periodik, inspektori, që, në bazë të rezultateve të vlerësimit, është vlerësuar:

a) shkëlqyeshëm”, “shumë mirë”, “mirë” ose “kënaqshëm”, konsiderohet se përmbush kërkesat për vazhdimësinë në detyrë;

b) “jokënaqshëm”, konsiderohet se nuk përmbush kërkesat për vazhdimësinë në detyrë dhe largohet nga detyra.

7. Mosparaqitja e inspektorit në testimin periodik, pa shkaqe të arsyeshme, konsiderohet shkelje dhe përbën shkak për dhënien e masës disiplinore.

8. Në kuptim të pikës 7 të këtij kreu, shkaqe të arsyeshme konsiderohen shkaqet e përmendura në pikën 13, të kreut II, të këtij vendimi, dhe në këtë rast inspektori i nënshtrohet testimit brenda 6 (gjashtë) muajve nga rikthimi në punë.

9. Procedurës së testimit periodik nuk i nënshtrohen inspektorët, të cilët janë në 5 (pesë)-vjeçarin e fundit, para daljes në pension.

KREU IV ORGANIZIMI I TESTIMIT FILLESTAR DHE PERIODIK

1. Testimi garanton uniformitet në vlerësimin profesional të inspektorit, në nivel kombëtar, përmes verifikimit të aftësive të nevojshme profesionale, sipas specifikave të çdo fushe inspektimi.

2. Përmbajtja e testimit përfshin legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, procedurat administrative, kundërvajtjet administrative, konfliktin e interesit, kodin e etikës, mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe aktet ligjore e nënligjore sektoriale për çdo strukturë përgjegjëse inspektimi.

3. Inspektorati i Përgjithshëm, në bashkëpunim me inspektoratin qendror, sipas fushës së inspektimit, harton dhe përditëson bankën e pyetjeve për testimin fillestar e periodik, në përputhje me parashikimin e pikës 2 të këtij kreu.

4. Inspektorati i Përgjithshëm përcakton kalendarin e zhvillimit të testimit periodik, fushat e legjislacionit, të cilat kanë pësuar ndryshime, si dhe të gjitha ndryshimet përkatëse.

5. Inspektorati i Përgjithshëm, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore në inspektoratet qendrore, harton listën e inspektorëve që do të marrin pjesë në testimin fillestar e periodik

dhe e shpall listën e inspektorëve në faqen zyrtare të inspektoratit qendror.

6. Mënyra e zhvillimit dhe administrimit të testimit bëhet sipas rregullave të përcaktuara në metodologjinë për testimin, të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm.

7. Inspektorati i Përgjithshëm, për zhvillimin e testimit:

a) harton modulet e trajnimit e të testimit dhe i publikon *on-line*;

b) harton kalendarin dhe publikon listat e inspektorëve, sipas datës së testimit;

c) mban e administron të gjitha dhënat për procesin e testimit në sistemin “*e-Inspektimi*”;

ç) verifikon identitetin e kandidatëve pjesëmarrës në vendin e testimit;

d) siguron kushte të përshtatshme në vendin e testimit për zhvillimin e testimit;

dh) publikon në faqen zyrtare rezultatet e testimit dhe ia njofton ato dhe inspektoratit qendror.

KREU V VLERËSIMI I TESTIT

1. KREK-u shpall skemën e vlerësimit të testit me shkrim e me gojë përpara fillimit të testimit, përfshirë pikët për secilën pyetje dhe raportin midis komponentëve të testimit, sipas legjislacionit bazë dhe atij sektorial.

2. Vlerësimi i përgjigjeve të inspektorit bëhet me pikë, si për testimin me shkrim, ashtu edhe për testimin me gojë.

3. KREK-u vlerëson me pikë inspektorin gjatë testimit me gojë për përgjigjen e secilës pyetje, duke u bazuar në:

a) njohuritë profesionale;

b) qartësinë e të shprehurit;

c) logjikën e argumentimit;

ç) zbatueshmërinë praktike të përgjigjeve;

d) sjelljen etike dhe komunikimin.

4. Për vlerësimin e përgjigjeve të testimit me gojë, secili prej anëtarëve të KREK-ut jep pikët e tij. Në përfundim, pikët mbledhen dhe më pas nxirret mesatarja e përgjithshme, e cila përbën edhe vlerësimin përfundimtar të inspektorit.

5. Përpara fillimit të vlerësimit të testimit me shkrim, anëtarët e KREK-ut orientohen për vlerësimin e njëjtë të testeve, sipas skemës përkatëse të vlerësimit.



6. Çdo anëtar i KREK-ut nënshkruan testin me shkrim, që vlerëson dhe mban përgjegjësi për vlerësimin që bën.

7. Vlerësimi i testit bëhet në mjedise të përshtatshme dhe të sigurta, të përcaktuara nga Inspektorati i Përgjithshëm.

8. Çdo përgjigje e testit i nënshtrohet një vlerësimi të pavarur nga të gjithë anëtarët e KREK-ut.

9. Vlerësuesit nuk mund të bëjnë shënime në testin me shkrim. Vlerësimet me pikë për çdo pyetje të testit me shkrim pasqyrohen në formularët përkatës.

10. Për vlerësimin përfundimtar, pikët për çdo pyetje të testit pasqyrohen në tabelën përmbledhëse dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e KREK-ut.

KREU VI

KARTA E INSPEKTORIT DHE CERTIFIKIMI NË PËRFUNDIM TË TESTIMIT

1. Pas kalimit me sukses të testimit fillestar, inspektori i konfirmuar pajiset me kartën e inspektorit.

2. Karta e inspektorit qendror lëshohet nga inspektori i Përgjithshëm.

3. Karta përmban emrin dhe mbiemrin e inspektorit, fotografinë e 2 (dy) viteve të fundit të inspektorit, numrin unik identifikues, datën e lëshimit dhe të skadimit të kartës, fushën e inspektimit ose specializimin, si dhe elemente të sigurisë për të parandaluar falsifikimin.

4. Karta e inspektorit prezantohet nga inspektorët gjatë ushtrimit të detyrës për të verifikuar identitetin dhe autoritetin e tyre.

5. Karta rinovohet menjëherë pas ndryshimeve të të dhënave personale ose profesionale të inspektorit.

6. Karta anulohet, nëse inspektori lirohet nga detyra apo nëse inspektorit i hiqet e drejta e ushtrimit të detyrës për shkak të shkeljeve ligjore ose masave disiplinore dhe dorëzohet menjëherë nga inspektori pranë njësisë së burimeve njerëzore të inspektoratit, ku ka emërimin. Njësia e burimeve njerëzore e përcjell me shkresë zyrtare pranë Inspektoratit të Përgjithshëm brenda 2 (dy) ditëve punë, si dhe e pasqyron anulimin në sistemin elektronik “*e-Inspektimi*”.

7. Në përfundim të trajnimit e të testimit, inspektori pajiset me certifikatën e trajnimit dhe të testimit, e cila lëshohet për të vërtetuar përfundimin e programeve të trajnimit të njohura nga Inspektorati i Përgjithshëm dhe testimit të njohurive të përfituara nga këto trajnime.

8. Certifikata përmban emrin dhe mbiemrin e inspektorit, datën e fillimit e të përfundimit të trajnimit, përshkrimin e qartë të temës ose aftësive të fituara, datën e zhvillimit të testimit dhe rezultateve të tij, nënshkrimin e inspektorit të Përgjithshëm dhe vulën e Inspektoratit të Përgjithshëm.

9. Certifikata dëshmon për kompetencat dhe aftësitë specifike të inspektorit, duke siguruar që të gjithë inspektorët u përmbahen standardeve të larta profesionale dhe etike të kërkuara për ushtrimin e funksioneve të tyre.

KREU VII ANKIMI

1. Inspektori, që i nënshtrohet testimit fillestar ose periodik, ka të drejtë të verifikojë përgjigjet e dhëna dhe të ankimojë, nëse ka kontestime për rezultatin. Inspektori paraqet ankimin pranë Inspektoratit të Përgjithshëm brenda 5 (pesë) ditëve punë nga njoftimi i rezultateve.

2. Inspektorati i Përgjithshëm, nëpërmjet një komisioni *ad-hoc*, që ngrihet me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm, shqyrton ankimin dhe i njofton vendimin e arsyetuar inspektorit, që ka paraqitur ankimin, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga përfundimi i afatit të ankimit.

3. Vendimi i komisionit *ad-hoc* është vendim përfundimtar dhe mund të ankimohet në gjykatën administrative kompetente, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga marrja dëgjimi.

KREU VIII DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Inspektorët aktualë në detyrë, të cilët nuk janë testuar për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë prej më shumë se 4 (katër) vitesh, i nënshtrohen testimit të parë periodik, që do të fillojë të kryhet brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.



2. Inspektorët, të cilëve u ka përfunduar periudha e provës përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe të këtij vendimi, nuk i nënshtrohen procedurës së testimit fillestar për konfirmimin në pozicionin e inspektorit.

3. Parashikimi i bërë në pikën 2 të këtij kreu zbatohet për inspektorët, marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës apo nga legjislacioni për nëpunësin civil.

4. Ngarkohen Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore dhe strukturat e tjera inspektuese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 427, datë 23.7.2025

**PËR AUTORIZIMIN E KORPORATËS SË
INVESTIMEVE SHQIPTARE PËR
ZHVILLIMIN E PRONAVE
SHTETËRORE PËR REALIZIMIN E
PROJEKTIT TË INVESTIMIT
“RIJETËZIMI I KOMPLEKSIT SPORTIV
‘SKËNDERBEU’, KORÇË, STADIUMIT
DHE ZONËS URBANE PËRRETH”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, me NIPT: M01917011D, vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, për të vepruar si zhvillues i pronave, të përcaktuara në

shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe autorizimit të dhënë nga Këshilli Bashkiak Korçë, nëpërmjet vendimit nr. 118, datë 31.8.2023, të ndryshuar me vendimin nr. 70, datë 21.7.2025, në funksion të realizimit të projektit të investimit “Rijetëzimi i kompleksit sportiv ‘Skënderbeu’, Korçë, stadiumit, pallatit të sportit dhe zonës urbane përreth”, i cili ka si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik.

2. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare dhe institucionet e përcaktuara në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, apo autoritetet e autorizuar prej tyre, që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik e përmbushjen e interesit të Korporatës, si dhe të entiteteve në pronësi të të cilit/ave regjistrohet prona e re shtetërore.

3. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për hapjen e procedurës konkurruese për përzgjedhjen e partnerit privat, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, për zhvillimin e pronës nëpërmjet instrumentit të sipërmarrjes.

4. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për negociimin me subjekte private, me qëllim lidhjen e kontratës përkatëse për zhvillimin e pronave për të cilat ka autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të projektit të investimit.

5. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit, si dhe të sigurojë regjistrimin, në emër të Republikës së Shqipërisë/Bashkisë Korçë/ Korporatës, sipas parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit, të pronës së re shtetërore, që do të krijohet në kuadër të projektit të investimit.

6. Në funksion të zhvillimit të pronave të përcaktuara në këtë vendim, në përputhje me



parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me prishjen e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Vendimi nr.568, datë 4.10.2023, i Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor për realizimin e projektit të zonës multifunkionale përreth kompleksit të stadiumit ‘Skënderbeu’ në Korçë,

përfshirë stadiumin”, shfuqizohet, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Bashkia Korçë, Federata Shqiptare e Futbollit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA NR. 1
PRONAT ME FUNKSION PUBLIK PËR TË CILAT KORPORATA VEPRON SI ZHVILLUES

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me përgjegjësi administrimi/ pronësi
				Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
1	8561	1/5	23934.7	23934.7	323.3	Bashkia Korçë
2	8561	1/4	464.1			Bashkia Korçë
3	8561	1/3	337.5			Bashkia Korçë
4	8561	1/560	137.3			Bashkia Korçë
5	8561	1/580	20.1			Bashkia Korçë
6	8561	1/561	102			Bashkia Korçë
7	8561	1/562	192.2			Bashkia Korçë
8	8561	1/6	528.9			Bashkia Korçë
9	8561	1/563	461.1			Bashkia Korçë
10	8561	1/25	8553.5			Bashkia Korçë
11	8561	1/581	1033.4	1033.4	180.8	Bashkia Korçë
12	8561	1/11	4746.8			Bashkia Korçë
13	8561	1/19	1208.4	1208.4		Bashkia Korçë
14	8561	1/559	356.6			Bashkia Korçë
15	8561	1/547	24.4			Bashkia Korçë
16	8561	1/912	85,836	85,836	250	Bashkia Korçë
17	8561	1/17	1564.6			Shtet
18	8561	1/7	1,012.80			Bashkia Korçë
19	8561	1/539	47.3			Bashkia Korçë
20	8561	1/540	48.6			Bashkia Korçë
21	8561	1/541	46.7			Bashkia Korçë
22	8561	1/542	49			Bashkia Korçë
23	8561	1/543	50.2			Bashkia Korçë



SHTOJCA NR. 2
INSTITUCIONET PUBLIKE, TË CILAT
LIDHIN MARRËVESHJEN E
BASHKËPUNIMIT ME KORPORATËN E
INVESTIMEVE SHQIPTARE

Bashkia Korçë, Federata Shqiptare e Futbollit
dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit

VENDIM
Nr. 428, datë 23.7.2025

**PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA E
INVESTIMEVE SHQIPTARE TË
PRONAVE SHTETËRORE PËR
REALIZIMIN E PROJEKTIT TË
INVESTIMIT “RIJETËZIMI I
KOMPLEKSIT SPORTIV ‘FLAMURTARI’,
VLORË, STADIUMIT, PALLATIT TË
SPORTIT DHE ZONËS URBANE
PËRRETH”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, dhe në vijim të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitëozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, me NIPT: M01917011D të pronave shtetërore, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për realizimin e projektit të investimit “Rijetëzimi i kompleksit sportiv ‘Flamurtari’, Vlorë, stadiumit, pallatit të sportit dhe zonës urbane përreth”.

2. Autorizimin e shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, për të vepruar si zhvillues i pronave, të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, sipas këtij vendimi, dhe autorizimit të dhënë nga Këshilli Bashkiak Vlorë, nëpërmjet vendimit nr. 78,

datë 28.9.2023, të ndryshuar me vendimin nr. 67, datë 21.7.2025, në funksion të realizimit të projektit të investimit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i cili ka si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik.

3. Autorizohen Korporata e Investimeve Shqiptare dhe institucionet publike përfituese, të përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik dhe përmbushjen e interesit të Korporatës, si dhe të entiteteve në pronësi të të cilit/ave regjistrohet prona e re shtetërore.

4. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për hapjen e procedurës konkurruese për përzgjedhjen e partnerit privat, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitëozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, për zhvillimin e pronës nëpërmjet instrumentit të sipërmarrjes.

5. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për negociimin me subjekte private, me qëllim lidhjen e kontratës përkatëse për zhvillimin e pronave të transferuara në pronësi apo për të cilat ka autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të projektit të investimit.

6. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimit të territorit apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit, si dhe të sigurojë regjistrimin, në emër të Republikës së Shqipërisë/Bashkisë Vlorë/Korporatës, sipas parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit, të pronës së re shtetërore, që do të krijohet në kuadër të projektit të investimit.

7. Në funksion të zhvillimit të pronave të përcaktuara në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me prishjen



e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

8. Vendimi nr. 734, datë 13.12.2023, i Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor, për realizimin e projektit të zonës multifunkionale përreth kompleksit të stadiumit ‘Flamurtari’ në Vlorë, përfshirë stadiumin”, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Bashkia Vlorë, Federata Shqiptare e Futbollit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA NR. 1
PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi
				Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
1	8602	12/17	5292	5292	-	Shtet
2	8602	12/31	1456	-	-	Shtet
3	8602	12/38	1363	1363	-	Shtet
4	8602	12/39	3107	3107	-	Shtet
5	8602	12/45	12	12	-	Shtet
6	8602	12/55	2669	2669	-	Shtet
7	8602	12/286/2	649	649	-	Shtet
8	8602	12/323	309	309	-	Shtet
9	8602	12/324	928	928	-	Shtet
10	8602	12/325	1881	1881	1881	Shtet
11	8602	12/364	5472	5472	-	Shtet
12	8602	12/424	145	145	-	Shtet
13	8602	12/516	280	280	-	Shtet
14	8602	12/518	742	742	-	Shtet
15	8602	12/550	697.4	697.4	-	Shtet
16	8602	12/587	170	170	-	Shtet



SHTOJCA NR. 2
PRONAT ME FUNKSION PUBLIK PËR TË CILAT KORPORATA VEPRON SI ZHVILLUES

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi
				Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
1	8602	12/26	19486	19486	-	Bashkia Vlorë
2	8602	12/34	10721	10721	-	Bashkia Vlorë
3	8602	12/37	3485	3485	-	Bashkia Vlorë

SHTOJCA NR. 3
INSTITUCIONET PUBLIKE, TË CILAT
LIDHIN MARRËVESHJEN E
BASHKËPUNIMIT ME KORPORATËN E
INVESTIMEVE SHQIPTARE

Bashkia Vlorë, Federata Shqiptare e Futbollit,
Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Komiteti
Olimpik Kombëtar Shqiptar

VENDIM
Nr. 429, datë 23.7.2025

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Florian Semani, zëvendësministër i Financave,
lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet
në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë

